

# Neglizhenca shtetërore që vret gratë

## RAPORT MONITORIMI

Shkurt - Prill 2023



AUTOR  
**KRISELDA  
DEDNDREAJ**

QENDRESA  
QYTETARE



**NED**

NATIONAL  
ENDORSEMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## **Tabela e përmbajtjes**

**1.Hyrje.**

**2.Qëndrimi i ligjit mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.**

**3.Neglizhenca ndërinstucionale dhe ndikimi në rritjen e kriminalitetit me bazë gjinore.**

**4.Kultura patriarkale në shtëpi, rrugë, dhe në gjykatë**

**5.Rekomandime.**

**6.Bibliografia**



## Hyrje

Dhuna në familje është një problem i thellë në Shqipëri e duket se viktimat kryesore të një fenomeni të tillë janë gratë. Këtë e bëjnë të njohur raporte të shumta të zhvilluara nga organizata ndërkombëtare edhe nga vetë institucione kombëtare. Një prej tyre, publikim nga Instat në vitin 2021 mbi krimet dhe drejtësinë penale, në një raport krahasimor mes meshkujve dhe femrave, 67% janë femra të dëmtuara nga krimet kundër martesës dhe familjes, 88% janë femra të dëmtuara nga krimet seksuale e 73% janë femra të dëmtuara nga vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit. <sup>1</sup>Në të njëjtën kohë, numri i krimeve me bazë gjinore dhe krimet në familje rritet vit pas viti duke parë sesi numri i veprës penale “dhunë në familje” në vitin 2017 ishte 1412, në krahasim me vitin 2021 ku numri shkon 1631.

Gjatë vitit 2022 numri i denoncimeve nga gratë për dhunën ishte 4000 (katër mijë) e numri i urdhër-mbrojtjeve për këto gra shkontë në 2500 (dy mijë e pesëqind). Nëse numri i denoncimeve arrin këto shifra, numri real i dhunës ndaj grave prezumohet të jetë me i lartë.

Sipas një publikimi nga Instat për vitin 2018, më shumë se gjysma e vajzave dhe grave nga mosha 15 deri në 74, kanë përjetuar një prej 5 formave të dhunës me bazë gjinore, ku forma më e shpeshtë është ajo e dhunës nga partnerë intim, duke zënë 62% të rastëve.<sup>2</sup>

Ndërkohë që dhuna me bazë gjinore duket të ketë zënë rrënjë thellë në Shqipëri, një fenomen me të cilin po përballemi çdo vit e më ashpër është edhe femicidi.

Femicidi është forma më e ashpër e një cikli të vazhdueshëm dhune dhe neglizhence, e cila merr trajtën e vrasjes me motivin e vetëm, të qenit grua.

Në vitin 2022, UNWomen publikoi një hartë interaktive mbi numrat e femicidit në Ballkanin Perëndimor prej vitit 2019. Në Shqipëri, Tirana dhe Fieri mbanin numrin me të lartë të femicidit, me 4 vrasje të grave në secilin qytet, e në Shkodër numri ishte 3 e më pas Mirdita, Kukësi, Divjaka, Elbasani, Librazhdi, Kavaja, Roskoveci dhe Kuçova me 1 vrasje për secilin qytet. <sup>3</sup>Në diskursin publik, shpesh herë na vihen para terma si “krim pasioni” ose “krim xhelozie”, duke bërë të duket se ekziston një dëshirë për t’iu larguar asaj çka ky krim është.

<sup>1</sup> <https://www.instat.gov.al/media/9937/press-release-krime-2021.pdf>

<sup>2</sup> <https://www.instat.gov.al/en/statistical-literacy/violence-against-women-and-girls-in-albania/>

<sup>3</sup> <https://eca.unwomen.org/en/stories/news/2022/11/first-femicide-interactive-map-for-albania-montenegro-and-serbia-launched>

Megjithse terminologjia e përdorur është vetëm në aspekt shoqëror, ndikon në krijimin e një kulture justifikuese, përsa i përket dhunës ndaj grave e deri tek vrasja.

Ligji ka një rol thelbësor në mënyrën sesi një temë e tillë trajtohet. Duke filluar nga legjislacioni vendas, konventat ndërkombëtare e deri tek trajtimi që bëhet nga gjykata, prokuroria e hallka të tjera të drejtësisë, tregon se si funksionon ky realitet në Shqipëri.

4

## Qëndrimi i ligjit mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nuk vendos në mënyrë të posaçame dispozita në shërbim të krimeve me bazë gjinore, duke mundësuar vetëm dispozitat mbi vrasjen për shkak të marrdhënieve familjare, dhuna seksuale si dhe dhunën në familje.

Praktika vazhdon të tregojë se këto forma të krimit kryhen në mënyrë disproporcionale mes gjinive, duke bërë që në shumicën dërrmuese të rastëve, viktimat të jenë gratë.

Dhuna me bazë gjinore si dhe vrasja me motiv gjinor, nuk është një fenomen i paevitueshëm, përkundrazi, duhet të parandalohet dhe të luftohet me çdo mekanizëm ligjor të mundshëm, duke filluar nga përforcime të legjislacioneve ekzistuese, ndjekje e rregullave dhe normativave të vendosura nga organizata ndërkombëtare për shtesa në legjislacion, ndërtim i mekanizmave rehabilitues dhe riedukues mbi mendësi kulturore e deri tek rritje e ndëshkueshmërisë.

Ligji luan një rol kryesor në ndërtimin e rregullatorëve të duhur përsa i përket ndalimit e ndëshkimit për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

Mënyra sesi ligji shkruhet e ajo sesi ligji zbatohet, është tregues i thellë sesi shoqëria funksion sot dhe sa e aftë është të zhdukë trende e tradita problematike apo kriminale në të ardhmen.

Nëse dënimi nuk është në proporcion me krimin, e paralelisht, brenda sistemit ekzistojnë mënyra për të ulur nivelin e ndëshkueshmërisë, krimi bëhet kulturë.

---



Kodi penal i Republikës së Shqipërisë parashikon një dispozitë të veçantë për vrasjen e bashkëshortit/bashkëshortës për shkak të marrëdhënieve familjare.

Neni 79 pika c në Kodin Penal parashikon jo më pak se 20 vite ose burgim të përjetshëm për vrasje të bashkëshortit/bashkëshortës, ose një personi tjetër në marrëdhënie familjare.

E megjithëse në legjislacion ekziston një dispozitë e posaçme e cila mund të vihet në praktikë për të rritur ndëshkueshmërinë për një krim të këtij karakteri, praktika shqiptare tregon se arrin të gjejë mënyra për të mos aplikuar në mënyre korrekte ligjin i cili na vihet në dispozicion.

Në rastin e ndodhur më 1 mars të këtij viti, autori i vrasjes së tre grave e plagosjes së tre grave të tjera, ishte një individ me të shkuar kriminale, ku krimet ndaj grave zinin pjesën më të madhe të historikut të tij kriminal. E megjithëse autori më parë ishte i dënuar për marrje peng me dhunë, përdhunim dhe vrasje të ish-bashkëshortes, kur në qershor të vitit 2022 u vendos përballë drejtësisë me akuzën dhunë në familje, gjykata e dënoi me vetëm 7 muaj burgim dhe faktet tregojnë se ndëshkueshmëria nga ana e ligjit dhe ligjvënësit nuk është në nivelet e duhura.

## **Neglizhenca ndërinstitucionale dhe ndikimi në rritjen e kriminalitetit me bazë gjinore**

10 vjeçari i fundit në Shqipëri ka shënuar 139 gra të vrara nga partnerë intim ose nga meshkuj të tjerë të rretheve të ngushta familjare.<sup>5</sup>

Në vitin 2021, numri i grave të vrara në Shqipëri ishte 12 dhe sipas statistikave nga Policia e Shtetit, në 10 vjeçarin e fundit, mesatarisht ky është edhe numri i vrasjeve të grave në vit.<sup>6</sup>

Numri i kërkesave për urdhër-mbrojtje gjatë vitit 2022 ishte 4000, prej tyre 2500 urdhëra-mbrojtje janë lëshuar.<sup>7</sup>

Statistikat tregojnë që jo vetëm se nuk është hera e parë që institucioneve i kërkohet ndihmë për të parandaluar krime potenciale, por kjo është bërë edhe normalja e re.

<sup>5</sup> <https://ina.media/?p=3539>

<sup>6</sup> [https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide\\_BLK\\_N\\_Report.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide_BLK_N_Report.pdf)

<sup>7</sup> <https://top-channel.tv/2022/11/24/dhuna-ndaj-grave-ne-nje-vit-2400-urdhra-mbrojtje/>

Nëse vite më parë, thirrja “denonco” ishte një thirrje e cila bëhej me zë të lartë, kemi arritur në pikën ku numri i denoncimeve është rritur, niveli i ndëshkueshmërisë duket se mbetet i ulët, duke bërë që rreziku për precipitim të veprave penale me bazë gjinore, të rritet.

Urdhërat e mbrojtjes lëshohen, por vërehet mungesë në zbatim. Mungesa e zbatimit fillon tek pasiviteti i institucioneve për mbrojtjen e viktimave, në rastet e lëshimit të urdhërave të mbrojtjes, duke qenë se numri më i lartë i denoncimeve vjen nga bashkëjetues. Kjo për rrjedhojë lind nevojën për ndërtimin e mekanizmave për sigurimin e mbrojtjes së viktimës nga institucionet.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës, i ngritur në Shqipëri që prej vitit 2006 përbëhet prej 15 institucioneve, të cilat duhet të bashkëpunojnë në mënyrë konstante me njëra-tjetrën, duke siguruar mbarëvajtjen e të gjithë proceseve që një person i cili ka përjetuar dhunën në familje kalon.

Sipas një studimi të nxjerre nga INA, në 14 bashki të Shqipërisë, vetëm 1 është numri i koordinatorëve vendorë për dhunën për secilën bashki, duke bërë që edhe eficaenca të jetë e ulët.

## **Kultura patriarkale në shtëpi, rrugë, dhe në gjykatë**

Informacione të mbledhura nga Policia e Shtetit në një raport të publikuar mbi Vrasjet e Grave në Ballkanin Perëndimor në Shqipëri, shtëpia është vendi më i rrezikshëm për gratë e ekspozuara ndaj dhunës. 58% e grave të vrara gjatë vitit 2021 janë ndodhur në ambientet e shtëpisë ku jetonin.<sup>8</sup>

Kultura patriarkale mendohet të jetë një ndër shkaktarët kryesorë të thellimit të krimit me bazë gjinore. Në Shqipëri, kultura patriarkale është e thellë, si në aspekt shoqëror deri në aspekt institucional.

Në një raport të përgatitur nga UN Women, më shumë se 1 (një) në 3 (tre) gra shqiptare tregojnë se ndihen të pasigurta në ambjentët e tyre familjare si pasojë e dhunës së ushtruar. 1 (një) në 2 (dy) besojnë se dhuna në familje është çështje personale e për pasojë nuk duhet të merret vesh jashtë rrethëve familjare, duke bërë që statistikat e përmendura më lart mbi numrat e raportimeve e atyre të urdhërave të mbrojtjes, të mos jenë në fakt shifra aspak të sakta në krahasim me realitetin në të cilin ndodhemi.

<sup>8</sup> [https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide\\_BLK\\_N\\_Report.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide_BLK_N_Report.pdf)



Shoqëria shqiptare është një shoqëri e ashpër sa i përket mënyres sesi një grua trajtohet e kjo ashpërsi thellohet kur nuk ka reagim në mënyrë proaktive nga institucionet, të cilët duhet të kenë funksion mbrojtës.

Në mënyre informale, shumë organizata feministe tregojnë histori të cilat për të ruajtur identitetin e viktimave, nuk bëhen publike, ku vetë Policia, në raste më pak të shpeshta edhe vetë Gjykata, vendosin në faj moral - gruan për raportimin mbi dhunën në familje.

Të dhënat tregojnë një mungesë ndërgjegjësimit kulturor e ndërinstytucional përsa i përket mbrojtjes së viktimave të dhunës me bazë gjinore. Kjo e vështirëson akoma më shumë përpjekjen drejt një shoqërie të drejtë dhe të barabartë e cila respekton të drejtat themelore të njeriut.

## Rekomandime

- Zbatimi i ligjit duhet të jetë fokusi kryesor i institucioneve në vend, duke ndihmuar në zhdukjen e fenomeneve si dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje e deri tek vrasja me bazë gjinore. Shqipëria duhet të ndjekë rregulloret dhe planet e draftuara nga organizata ndërkombetare si: OSBE, Këshilli i Europëse nga konventa të ndryshme ndërkombëtare mbi mënyren sesi çështje të caktuara duhet të trajtohen;
- Reforma në Drejtësi duhet të funksionojë edhe në përzgjedhjen e integritetit në trupat gjykues sa i përket çështjeve të një karakteri të fillë, duke e bërë drejtësinë krah me viktimën;
- Strategjitë, planet e veprimit dhe politika mbi promovimin e barazisë gjinore duhet të behën pjesë e praktikave, duke përfshirë legjislacionin që mbron gratë dhe vajzat nga të gjitha format dhunës, duke përfshirë edhe forma të reja, të dhunës me bazë gjinore, si përdorimi i teknologjise në dhunën seksuale. Kodi penal i Republikës së Shqipërisë nuk ka ende një dispozitë të veçantë mbi pornogafinë hakmarrëse, apo forma të tjera të dhunës seksuale duke përdorur internetin;
- Duhet të ketë një bashkëpunim të thellë mes shoqërisë civile dhe institucioneve në ndihmë të viktimave të dhunës;
- Ndryshimi i legjislacionit sa i përket autorëve të krimeve në familje si dhe një rishikim të thellë të mënyrës sesi sistemi i burgut funksionon dhe sa efektiv është mbi riedukimin e të dënuarve. Mundësimi i mekanizmave financiarë duhet të jenë në fokus kryesor të institucioneve të vendit. Shteti duhet të ketë aftësi financiare për të mundësuar rritjen e sigurisë së viktimave në



rastet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, urdhërmbrojtjes, si dhe pas dënimit të autorit të krimit;

- Ndërtim i metodikave për të parandaluar vazhdimësinë e një kulture dhunuese dhe seksiste duke ndërmarrë aktivitete dhe forma të tjera të rritjes së ndërgjegjësimit shoqëror në nivel kombëtar;
- Përmirësim i mbledhjes dhe transparencës së të dhënave mbi dhunën në familje, dhunën me bazë gjinore dhe vrasjet me motiv gjinor nga ana e Ministrisë së Drejtësisë;
- Ndërmarrje e aktiviteteve mbi ndërgjegjësimin e rëndësishëm që raportimi i dhunës ka për viktimën. Krijimi i mundësive dhe faciliteteve për t'i ardhur në ndihmë të menjëhershme viktimave të dhunës në familje ose dhunës me bazë gjinore.

## Bibliografia

“Violence against Women and Girls in Alba...” *Instat*, <https://www.instat.gov.al/en/statistical-literacy/violence-against-women-and-girls-in-albania/>.

*Statistikat e Krimeve Dhe Drejtësisë Penale, 2021 - Instat.gov.al*. <https://www.instat.gov.al/media/9937/press-release-krime-2021.pdf>.

“First Femicide Interactive Map for Albania, Montenegro and Serbia Launched.” *UN Women – Europe and Central Asia*, <https://eca.unwomen.org/en/stories/news/2022/11/first-femicide-int%C3%ABractive-map-for-albania-mont%C3%ABnegro-and-serbia-launched>.

“Vrasjet e Grave, 139 Vajza Të Vrrara Në 10 Vite: As Sistemi I Drejtësisë Nuk Është Çliruar Nga Mentaliteti Patriarkal.” *INA*, 5 May 2022, <https://ina.media/?p=3539>.

*Media Reports on the Case Indicate That D.S. Was Exposed to Long Term ...*  
[https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide\\_BLKN\\_Report.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide_BLKN_Report.pdf).

“Dhuna Ndaj Grave, NË NJË VIT 2400 Urdhra Mbrojtjeje.” *Top Channel*, <https://top-channel.tv/2022/11/24/dhuna-ndaj-grave-ne-nje-vit-2400-urdhra-mbrojtjeje/>.



Media Reports on the Case Indicate That D.S. Was Exposed to  
Long Term ...

[https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide\\_BLKN\\_Report.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/2021%20Femicide_BLKN_Report.pdf).

"Dhuna Ndaj Grave, NË NJË VIT 2400 Urdhra Mbrojtjeje." *Top Channel*, <https://top-channel.tv/2022/11/24/dhuna-ndaj-grave-ne-nje-vit-2400-urdhra-mbrojtjeje/>

*Violence against Women in Politics - Undp.org.*  
<https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/Raport-Dhuna-Ndaj-Grave-ne-Politike-ENG.pdf>

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE